

***Prodhuesi i filmave si pjesë parazitare e simbiozës:  
Infeksionet oportuniste (infeksione që nuk e dëmtojnë trupin e  
shëndetshëm por atë me sistem imun të dobët) të aparatit  
mbikqyrës***

**Manifesti për prodhuesit e filmave të Kamerave Mbikqyrëse (KM)** shpall një varg rregullash, vendos procedura efektive dhe identifikon çështjet kryesore për prodhuesit e filmave të cilët e përdorin sistemin (mbikqyrës) KM si media në Mbretërinë e Bashkuar. Manifesti është hartuar bazuar në Aktin e Mbrojtjes të të Dhënave (AMDh), 1998, dhe legjislacionin përkatës të privatësisë që i jep të drejtë subjektit që regjistron të dhënat, të përdorë kopjet e të dhënave. Kështu pajisjet standarte të prodhuesit të filmave bëhen të panevojshme: përdorimi i tyre është i ndaluar. Manifesti mund të përshtatet për juridiksione të ndryshme.

\* \* \*

## **MANIFESTI PËR PRODHUESIT E FILMAVE KM**

### **1. E PËRGJITHËSHME**

**Prodhuesi i filmave nuk është i lejuar të futë kamera ose ndriçime në mjedis.**

### **2. SKENARI**

**Protagonisti ("subjekti i të dhënave") kërkohet që të jetë i pranishëm në të gjitha sekuencat.**

*Akti i Mbrojtjes të të Dhënave 1998; 1998 Kapitulli 29; Pjesa II, Paragrafi 7(1).*

Individi ka të drejtë

- a) të informohet nga çdo kontrollues i të dhënave nëse të dhënat personale në të cilat individi është subjekt janë përpunuar nga ose në emër të këtij kontrolluesi të dhënash
- b) në rast të tillë prej kontrolluesit duhet të jepet një përshkrim i:
  - i) të dhënave personale të individit i cili është subjekti i të dhënave
  - ii) qëllimit për të cilin ato po përdoren ose do të përdoren, dhe
  - iii) përdoruesit ose kategoritë e përdoruesve, të cilëve ato u janë dhënë ose mund t'u jepen
- c) t'i komunikohet në një formë të qartë
  - i) informacioni që përbën çdo të dhënë personale të individit, i cili është objekt i të dhënave, dhe
  - ii) çdo informacion të mundshëm që ka kontrolluesi i të dhënave në lidhje me burimin e këtyre të dhënave
- d) atëhere kur procesimi përmes pajisjeve automatike i të dhënave personale ku individi është subjekt me qëllim vlerësimin e tij, si p.sh. performancën e tij në punë, kredibilitetin, besueshmërinë, apo sjelljen etj., pra kur ky është ose ka gjasa të jetë arsyeja e vetme në vendimmarrje me rëndësi të madhe për të, ai duhet të informohet nga kontrollori në lidhje me logjikën e përdorur në vendimmarrje.

**Aktiviteti i dokumentuar i protagonistit duhet të cilësohet si të dhëna personale të ndjeshme. Këtë duhet ta vendosë prodhuesi i filmit duke vendosur një KM dhe duke kufizuar fushën e veprimit që lidhet me aktorët, në mënyrë që ngjarjet me lidhje biografike (dmth. që zbulojnë të dhëna personale) të ndodhin brenda kuadrit.**

*Akti i Mbrojtjes të të Dhënave dhe sistemeve KM i Zyrës të Komisionerit për Informacionin (ZKI) JBv.5 01/02/04*

2. Gjykata vendosi që në mënyrë që informacioni të lidhet me një individ (dhe të mbulohet nga AMDh) ai duhet të ndikojë në privatësinë e individit. Për të vendosur në lidhje me privatësinë, Gjykata vendosi se dy ishin çështjet kryesore: që personi duhet të jetë në fokus të informacionit, dhe informacioni duhet të tregojë diçka të rëndësishme për të.

*Dispozitat e Aktit të vitit 1998 janë bazuar mbi kërkesat e një Udhëzimi European i cili, tek Neni 2, përcakton të dhënat personale si vijon:*

“Të dhëna personale” nënkupton çdo informacion që lidhet me një person të indentifikuar ose të identifikueshëm, një person i identifikueshëm është ai person i cili mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes një numri identifikimi ose të një apo më shumë faktorëve specifikë të identitetit të tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror. Përkufizimi i të dhënave personale kështu nuk kufizohet vetëm në rastet, kur një kontrollues të dhënash mund të emërtojë një imazh të caktuar. Nëse procesohen imazhe të tipareve të dallueshme të individit dhe ky individ mund të identifikohet nga këto imazhe, ato mund të përkufizohen si të dhëna personale.

**Të gjithë njerëzit përveç protagonistit (“personat e tretë”) do paraqiten të pa-indentifikueshëm në të dhënat e siguruar nga operatorët KM. Zakonisht operatorët i turbullojnë ose maskojnë fytyrat e personave të tretë. Prodhuesi i filmit duhet të vlerësojë ndikimin pamor të këtij ndryshimi dhe të vendosë një rregull për trajtimin e regjistrimeve me maskim ose turbullim jo të mirë – për shembull ta raportojë këtë shkelje.**

*E Drejta për Privatësi, Neni 8 në Aktin e të Drejtave të Njeriut viti 1998:*

**E DREJTA PËR TË RESPEKTUAR JETËN PRIVATE DHE FAMILJARE.**

1. Çdo njeri ka të drejtë të respektohet për jetën private ose familjare, shtëpinë dhe letërkëmbimin e tij.

2. Autoritetet publike nuk mund të ndërhyjnë në ushtrimin e kësaj të drejte përveç se në përputhje me ligjin dhe kur është e nevojshme nga shoqëria demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqënies ekonomike të vendit; për parandalimin e trazirave ose krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

*AMDh 1998*

4. Nga ana tjetër zbulimi i informacionit për personat e tretë në pajtim me kërkesën e subjektit për përdorim të të dhënave mund ta vendosë kontrolluesin e të dhënave para ankesave ose veprimeve të palës së tretë, për shembull [...] për shpërdorim të mirëbesimit.

6. Kontrolluesi i të dhënave duhet të konsiderojë se në çfarë mase është e mundëshme të jepet informacioni i kërkuar pa zbuluar të dhëna për personat e tretë [...].

Kjo arihet përmes redaktimit të informacionit duke hequr emrat ose detaje të tjera identifikuese.

### 3. MJEDISI

**Prodhuesi i filmit zgjedh mjediset e mbuluara nga shumë kamera të drejtuara nga një biznes i madh, firmë sigurimi private ose autoritet publik – ose, nëse drejtohet nga një aktivitet i vogël, kamera të cilat mund të panoramojnë ose largojnë dhe afrojnë me telekomandim. Mjediset mund të jenë të lëvizëshme (p.sh. autobus publik).**

*Akti i Mbrojtjes të të Dhënave dhe sistemeve KM të Zyrës të Komisionerit për Informacionin (ZKI) JBv.5 01/02/04*

Nëse ju keni vetëm një sistemin të thjeshtë të KM përdorimi juaj nuk mund të mbulohet nga AMDH.

[...] Nuk mbulohen aktivitetet e vogla të cilat

- kanë vetëm disa kamera
- nuk mund t'i drejtojnë ato me telekomandim
- regjistrojnë në shirit videokasete gjithçka që kap kamera
- i japin imazhet e regjistruara policisë për të hetuar një incident në dyqanin e tyre.

**Për çdo kamera, duhet të ceket emri dhe të dhënat kontaktuese të operatorit.**

*Kodi i praktikës i hartuar nga Komisioneri i Mbrojtjes të të Dhënave, nën Paragrafin 51(3)(b) të Aktit të Mbrojtjes të të Dhënave 1998, 07/2000.*

7. Duhet të vendosen shenja që publiku të jetë i vetëdijshëm që po hyn në një zonë e cila mbulohet nga pajisje të mbikëqyrjes.

Shenjat duhet të japin informacionin e mëposhtëm:

Identitetin e personit ose organizatës përgjegjëse për sistemin mbikëqyrës.

Qëllimet e këtij sistemi.

Detaje se kë duhet të kontaktojnë në lidhje me sistemin.

(Parimi i Parë i Mbrojtjes të të Dhënave).

### 4. KËRKESAT E REGJISTRIMEVE

**Pas çdo xhirimi prodhuesi duhet të dërgojë një kërkesë me shkrim (“letër kërkesë për përdorimin nga subjekti”) tek operatori KM (“kontrolluesi i të dhënave”) për të siguruar që mund të fillojë nxjerrja e të dhënave ndërkohë që regjistrimet janë ende në arkiv. (Periodha e detyrueshme e mbajtjes në arkiv ndryshon)**

*Kodi i praktikës i nxjerrë nga Komisioneri i Mbrojtjes të të Dhënave, nën Paragrafin 51(3)(b) të Aktit të Mbrojtjes të të Dhënave 1998, 07/2000.*

Kur përfundon periodha e kohës së ruajtjes, imazhet duhet të largohen ose fshihen (Parimi i Pestë i Mbrojtjes të të Dhënave).

**Letër kërkesa nga subjekti duhet të cekë vendin dhe kohën e regjistrimit dhe të ketë një foto të protagonistit (nëse është e mundur i veshur me të njëjtat rroba) dhe një çek prej 10£ (tarifa më e lartë e aplikuar). Letrat duhet të dërgohen me një sistem të sigurtë që mundëson vërtetimin e pranimit. (Disa kontrollues të**

## **dhënash mund të kërkojnë noterizimin e letrës në mënyrë që identiteti të vërtetohet ligjërisht).**

*Akti i Mbrojtjes të të Dhënave 1998; 1998 Kapitulli 29, Pjesa II Paragrafi 7(2).*

Një kontrollues të dhënash nuk është i detyruar të japë ndonjë informacion sipas nënparagrafit (1) deri sa të marrë –

a) një kërkesë me shkrim, dhe

b) tarifën që ai vendos (që nuk e tejkalon shumën maksimale të caktuar), me përjashtim të rasteve të paracaktuara.

## **Prodhuesi i filmit pas dërgimit të kërkesës duhet të presë deri në 40 ditë për një përgjigje fillestare.**

*Kodi i praktikës i hartuar nga Komisioneri i Mbrojtjes të të Dhënave, nën Paragrafin 51(3)(b) të Aktit të Mbrojtjes të të Dhënave 1998, 07/2000.*

Një kontrollues të dhënash duhet t'i përgjigjet me korrektësi kërkesës së subjektit dhe në çdo rast brenda dyzet ditësh të marrjes së kërkesës ose, nëse është më vonë, brenda dyzet ditësh të marrjes së:

informacionit të kërkuar, (p.sh. të sigurohet për sa i përket identitetit të personit që bën kërkesën dhe të përcaktojë informacionin që kërkon personi); dhe taksës.

## **Prodhuesi i filmit duhet të vendosë një varg rregullash për mbajtjen në formate të ndryshme në të cilat mund të dërgohen të dhënat (shirit videokasete, video DVD, dokumenta dixhitale të koduara me kodet e pronësisë, kopje të zhvilluara (printuara) shtypura të imazheve, etj.).**

### **5. ZËRI**

**Sistemet KM nuk lejohen të regjistrojnë zëra. Prodhuesi i filmit duhet të vendosë një varg rregullash për kolonën zanore (nëse ka) të filmit.**

### **6. SHPËRNDARJA**

**Regjistrimi i marë është subjekt i çështjeve komplekse të të drejtave të autorit. Prodhuesi i filmit duhet të marrë informacione ligjore dhe të krijojë një strategji.**

\* \* \*